



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 58, datë 17.07.2026

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.73, DATË 23.12.2025, “PËR MIRATIMIN BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2026 DHE PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028”**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, i ndryshuar, Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.73, datë 23.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Grupi i Menaxhimit Strategjik, me propozim të Kryetares së Bashkisë,



**KËSHILLI BASHKIAK**  
**VENDOSI:**

1. Miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 73, datë 23.12.2025, “Për miratimin buxhetit të bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm 2026-2028”, përsa i përket buxhetit të vitit 2026 për Qendrën Ekonomike të Arsimit duke bërë rishpërndarjen e fondeve sipas tabelës së mëposhtme:

| Gr. | Programi | Kap. | Llog.ekon    | Kodi<br>njësisë<br>shpenzuese | Emërtimi i njësisë shpenzuese | Shtesë 2026<br>(në lekë) | Pakësim<br>2026<br>(në lekë) |
|-----|----------|------|--------------|-------------------------------|-------------------------------|--------------------------|------------------------------|
| 00  | 09120    | 5    | 602          | 2107008                       | Qendra Ekonomike e Arsimit    |                          | 1,112,400                    |
| 00  | 09120    | 5    | 231          | 2107008                       | Qendra Ekonomike e Arsimit    | 1,112,400                |                              |
|     |          |      | <b>Total</b> |                               |                               | <b>1,112,400</b>         | <b>1,112,400</b>             |

2. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Arsim Kulturë, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare dhe Qendra Ekonomike Arsimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETARE**

**Denisa Luarasi**



**U shpall sot me datë 20.07.2026**






REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 566/6 prot.

Durrës, më 27 . 07 .2026

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit



**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.58 datë 17.07.2026 “Për miratimin e ndryshimit të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.73, datë 23.12.2025, “ Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm 2026-2028”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI  
ADRIAN GURRA**

